



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA JURIDIKE

RELACION

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATES NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK FIER, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Këshilli Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Këshill për shkak të dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të njërit prej anëtarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar znj. Marsjola Irfan Begaj, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatës për anëtare në këshillin bashkiak znj. Marsjola Irfan Begaj, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1610 prot., datë 26.03.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1609 prot., datë 26.03.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidaten për anëtare në këshillin bashkiak, znj. Marsjola Irfan Begaj, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-873/1 prot., datë 28.03.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidaten për anëtare në Këshillin Bashkiak Fier, sipas të cilës rezulton se znj. Marsjola Irfan Begaj, është e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.



Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar Kreut V paragrafi i fundit, pikës 2, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për kandidatin për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilës nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli bashkiak përkatës dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

Dëshira Pasko – Drejtorja Juridike

Ylli Merkaj – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

